L I G J
Nr.9561, datë 12.6.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8744, DATË 22.2.2001 "PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE TË SHTETIT NË NJËSITË E QEVERISJES VENDORE"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", në nenin 17 bëhen këto ndryshime:

Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

"Transferimi i pronave përfundon sipas procedurave të këtij ligji. Transferime të tjera kryhen sa herë që do të ketë shtesa të funksioneve të njësive të qeverisjes vendore.".

2. Shkronjat "a", "b" dhe "ç" të paragrafit të dytë ndryshohen si më poshtë:

"a) Nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, njësitë e qeverisjes vendore paraqesin në Këshillin e Ministrave listën e pronave, që kërkojnë t'u transferohen, në përputhje me krerët II dhe III të këtij ligji.

b) Këshilli i Ministrave, pasi shqyrton kërkesat e paraqitura nga njësitë e qeverisjes vendore, sipas shkronjës "a" të këtij neni, merr vendimin paraprak për listën e pronave, që do t'ia transferojë çdo njësie të qeverisjes vendore. Lista e pronave, që transferohen së bashku me kushtet dhe kufizimet që përcakton Këshilli i Ministrave, sipas këtij ligji, i njoftohet njësisë së qeverisjes vendore, e cila, brenda 10 ditëve nga data e njoftimit, e shpall atë publikisht.

ç) Këshilli i Ministrave, jo më vonë se 3 muaj nga data e marrjes së kundërshtimeve, vendos përfundimisht për transferimin e pronës, për të cilën ka kundërshtim nga njësia e qeverisjes vendore përkatëse, së bashku me ndonjë kusht ose kufizim që duhet zbatuar për këto prona.".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4944, datë 27.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu